



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRI

URDHËR

Nr. 138, Datë 30.3 2017

PËR

MIRATIMIN E MANUALIN TË PËRKUFIZIMEVE NË ZBATIM TË LIGJIT 35/2016
“PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA TO”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 188, pika 3, të Ligjit nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”

URDHËROJ:

1. Miratimin e manualit të përkufizimeve të ligjit nr 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, duke përfshirë edhe shpjegimet në nenet përkatëse të këtij ligji, sipas Aneksit I bashkëngjitur këtij urdhëri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse për komunikimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



MINISTËR

MIRELA KUMBARO FURXHI

Aneksi I

1. “Administrim individual” nënkupton administrimin e të drejtave pasurore dhe vetjake jopasurore të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, si rezultat i përdorimit të veprës, objekt i mbrojtjes, nga vetë mbajtësi i së drejtës ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, sipas kontratës së lidhur me subjektin përdorues për kushtet e përdorimit.”
2. “Administrim kolektiv” nënkupton administrimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, si rezultat i përdorimit të veprës, objekt i mbrojtjes, nga një agjenci e administrimit kolektiv, e licencuar nga Ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit për një kategori të caktuar të drejtash, sipas kontratës së lidhur me subjektin përdorues për kushtet e përdorimit.”
3. “Administrim kolektiv i detyrueshëm” nënkupton administrimin e një kategorie të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, si rezultat i përdorimit të veprës, objekt i mbrojtjes, të cilat ushtrohen nëpërmjet administrimit kolektiv në mënyrë të detyrueshme nga një agjenci e licencuar.”
4. “Afat i mbrojtjes së të drejtave” nënkupton periudhën kohore që parashikon ky ligj për mbrojtjen e të drejtave pasurore të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, sipas parashikimeve të ligjit për të drejtën e autorit, ndërsa të drejtat vetjake jopasurore mbrohen pa asnjë kufi kohor.”
5. “Agjenci e Administrimit Kolektiv” nënkupton subjektin juridik, të krijuar më parë nga mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to dhe e licencuar nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit si agjenci me objekt të veprimtarisë së saj administrimin e një, dy ose më shumë kategori të drejtash, me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga përdorimi i veprave për të cilat janë autorizuar nga mbajtësit e këtyre të drejtave dhe shpërndarjen e tyre tek anëtarët e tyre-mbajtës të së drejtave, duke mbajtur detyrimet tatimore, si agjent tatimor sipas parashikimeve ligjore.
6. “Arbitrazhi” nënkupton procedurën që mund të ndjekin subjektet e interesuara për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre për rastet e përjashtimeve dhe kufizimeve të zbatimit të masave teknologjike të parashikuara në pjesën VI të ligjit për të drejtën e autorit.

7. “Autor i veprës” nënkupton çdo person fizik ose një grup personash fizikë që krijon/krijojnë vepër letrare, artistike, shkencore, produkt intelektual origjinal, i materializuar, pavarësisht nga forma dhe mënyra e të shprehurit.
8. “Autorët e kontributeve në veprën audiovizuale” nënkuptojnë personat fizikë ose një grup personash fizikë të cilët edhe pse nuk konsiderohen bashkëautorë të veprës audiovizuale ose kinematografike kanë të drejta autoriale në lidhje me kontributet e tyre individuale në vepër, të tillë si skenografët, kostumografët, artistët e *make up*-it dhe redaktorët.
9. “Autorizim për përdorim” nënkupton kontratën e lidhur ndërmjet agjencisë/mbajtësit të së drejtës dhe subjektit përdorues, qoftë ky person fizik ose juridik, në formën jo ekskluzive, për përdorimin e veprave që administrojnë brenda tagrave të licencës/mbajtësi i së drejtës kundrejt shpërblimit, përpara se subjekti përdorues të fillojë të përdorë veprat e mbrojtura nga ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.
10. “Bashkautorësia” nënkupton rezultatet e përpjekjeve të përbashkëta krijuese të dy ose më shumë autorëve mbi një vepër, e cila u përket atyre në mënyrë të përbashkët, pavarësisht nëse vepra përbën një të tërë të pandashme ose është bashkim i pjesëve të pavarura të secilit prej tyre.
11. “Bazae të dhënave” nënkupton një mbledhje të krijimeve të pavarura dhe të dhënave ose materialeve të renditura në mënyrë sistematike ose metodike, që janë të aksesueshme me anë të mjeteve elektronike ose mjeteve të tjera, mbrojtja e të cilës nuk shtrihet përse i përket përmbytjes së materialeve që përbëjnë këtë bazë të dhënash dhe nuk cenon të drejtat ekzistuese mbi to, si dhe nuk zbatohet për programet kompjuterike të përdorura në përgatitjen ose përdorimin e bazës së të dhënave, të cilat janë të arritshme nga mjetet elektronike.”
12. “Botues” nënkupton personin fizik ose juridik i cili ka të drejtën ekskluzive të botimit të veprës, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratën me autorin, për të riprodhuar veprën nëpërmjet shtypshkrimit ose proceseve të tjera të ngjashme, si dhe të drejtën e shpërndarjes së kopjeve të veprës tek publiku, duke shpërblyer autorin në shumën e rënë dakort si dhe duke përmushur detyrimet e tjera kontraktore dhe ligjore.”
13. “Detyrimi për dhënie informacioni” nënkupton detyrimin ligjor që kanë organet kompetente të administratës shtetërore ose personat e tjerë juridikë kundrejt agjencive të administrimit kolektiv, për të dhënë informacionin përkatës nga të dhënat që ato disponojnë, për sa e lejon

legjislacioni i posaçëm në fuqi, në rastet kur agjencitë nuk kanë informacion të mjaftueshëm për përdorim të paautorizuar të veprave objekt i mbrojtjes.”

14. “Domen publik” nënkupton tipologjinë ose regjimin e përdorimit të lirë nga publiku të veprave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, të cilave ose u ka mbaruar afati ligjor i mbrojtjes ose nuk kanë qenë ndonjëherë nën këtë mbrojtje.”
15. “Aksesi mbi veprën” nënkupton rastin kur autori ka të drejtë t’i kërkojë pronarit/titullarit të të drejtave apo poseduesit të veprës origjinale ose kopjes së saj që t’i lejojë mundësinë e qasjes ose aksesit, vetëm për qëllim të bërjes së kopjeve mbi veprën ose vepra të prejdardhura, sipas parashikimeve ligjore, si dhe pa cenuar interesin legjitim të mbajtësit të të drejtave ose poseduesit të veprës.”
16. “E/të drejta/t vetjake jopasurore” nënkuptohen ato të drejta që sigurojnë respektin ndaj cilësive intelektuale dhe personale në punë të autorit, konkretisht, e drejta e bërjes publike të veprës; e njohjes dhe përmendjes së autorësisë; e nderit, e personalitetit dhe reputacionit; e tërheqjes së lejes për shfrytëzimin e veprës; të cilat nuk përbëjnë objekt dorëheqjeje, nuk janë të transferueshme, të licensueshme, të tjetërsueshme dhe nuk parashkruhen”
17. “E drejta e bërjes publike të veprës” nënkupton të drejtën vetjake jopasurore të autorit, për të vendosur për kohën, vendin dhe për mënyrën me të cilën dëshiron t’ia bëjë të njohur për herë të parë veprën publikut, si dhe përpara bërjes publike të kësaj vepre, çdo informacion në lidhje me përmbajtjen mund t’i jepet publikut vetëm me pëlqimin e tij.
18. “E drejta e njohjes dhe përmendjes së autorësisë” nënkupton të drejtën vetjake jopasurore të autorit, për t’u njohur dhe përmendur si autor i veprës sipas parashikimeve të këtij ligji.
19. “E drejta e nderit, personalitetit dhe reputacionit” nënkupton të drejtën vetjake jopasurore të autorit që pavarësisht nga të drejtat pasurore të tij, edhe pas transferimit të këtyre të drejtave në fjalë, ka të drejtën të kundërshtojë çdo shtrembërim, ndryshim, tjetërsim ose veprime të tjera denigruese që nuk respektojnë tërësinë e veprës, duke cenuar nderin, personalitetin dhe reputacionin e tij, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
20. “E drejta e tërheqjes së lejes për shfrytëzimin e veprës” nënkupton të drejtën vetjake jopasurore të autorit ose trashëgimtarëve të tij, të cilët e fitojnë këtë të drejtë sipas legjislacionit civil dhe dispozitave të këtij ligji, që ka/kanë të drejtë të tërheqë/in lejen/autorizimin për shfrytëzimin e veprës dhe të ndalojë/në përdorimin në vazhdimësi të saj

që është bërë publike, duke u bazuar në arsye të mirëqena, mbrojtjen e reputacionit, nderit ose rrethanave të tjera, sipas parashikimeve të këtij ligji.

21. “E/të drejta/t ekskluzive pasurore” nënkuptohen ato të drejta për të gëzuar, autorizuar apo ndaluar përdorimin e veprave ose kopjeve të veprave të tyre, konkretisht, në mënyrë specifike, të drejtën e riprodhimit të veprës, të drejtën e shpërndarjes së veprës, të drejtën e komunikimit në publik të veprës, të drejtën për të bërë vepra të prejardhura, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
22. “E drejta e riprodhimit” nënkupton të drejtën ekskluzive pasurore e autorit për të autorizuar ose ndaluar bërjen e një ose më shumë kopjeve të një vepre apo objekti të të drejtave të lidhura, qoftë pjesërisht ose plotësisht, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme, në çfarëdolloj forme dhe mjete, përfshirë regjistrimin audio ose video, si dhe për ruajtjen e përkohshme apo të përhershme të veprës apo objektit të të drejtave të lidhura në një mjedis elektronik.
23. “E drejta e shpërndarjes” nënkupton të drejtën ekskluzive pasurore të autorit për të autorizuar ose ndaluar vënien, në mënyrë të ligjshme, në dispozicion të publikut, origjinalet ose kopjet e veprës apo të drejtat e tjera të lidhura me të, nëpërmjet shitjes apo tjetërsimeve të tjera dhe që i ofrohen publikut me këtë qëllim, si dhe importimin, eksportimin, shpërndarjen e kopjeve të veprave të prodhuara me pëlqimin e tij, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
24. “E drejta e qiradhënies” nënkupton të drejtën ekskluzive pasurore për të gëzuar ose autorizuar dhënien me qira për një periudhë të kufizuar kohore ose për të ndaluar dhënien me qira të veprës së autorit, në lidhje me origjinalin dhe kopjet e veprës së tij; interpretuesit, në lidhje me fiksimin e performancës së tij; prodhuesit të fonogramit, në lidhje me fonogramet e tij; prodhuesit të fiksimit të parë të një filmi, në lidhje me origjinalin dhe kopjet e filmit të tij.”
25. “E drejta e komunikimit në publik të veprës” nënkupton të drejtën ekskluzive pasurore të autorit për të autorizuar ose ndaluar komunikimin e veprës së tij në publik, e drejtë që përfshin në veçanti:
 - a) të drejtën e shfaqjeve publike si:
 - i) e drejta e recitimit/shfaqjes në publik të veprave të fushës letrare ose shkencore që lexohen ose recitohen/shfaqen në mënyrë të drejtpërdrejtë;

ii) e drejta e shfaqjes muzikore në publik të veprave muzikore të interpretuara në mënyrë të drejtpërdrejtë;

b) të drejtën e shfaqjes skenike në publik, që do të thotë prezantim i drejtpërdrejtë i veprave dramatike, dramatiko-muzikore, si dhe veprave koreografike apo në pantomime në publik;

c) të drejtën e përcjelljes në publik të një vepre, që është e drejta për të përcjellë një recitim, shfaqje muzikore ose një shfaqje skenike të një vepre tek publiku që nuk është i pranishëm në vendin ku interpretohet vepra dhe tek i cili përcillet me anë të altoparlantit, ekranit apo mjeteve të tjera teknike;

ç) të drejtën e përcjelljes në publik të veprave të palëvizshme/të fiksuara, që do të thotë paraqitja e veprave të vendosura në fonogram ose videogram, me anë të fonogramit ose videogramit;

d) të drejtën e paraqitjes publike, që do të thotë ekspozimi publik i veprave të artit pamor, të arkitekturës, të arteve të aplikuara, i një punimi fotografik; krijimi kinematografik ose çdo punim tjetër audiovizual, një punimi hartografik ose një prezantimi me natyrë shkencore apo teknike me anë të mjeteve teknike;

dh) të drejtën e transmetimit për publikun të një vepre, që përfshin përcjelljen e veprës me anë të çdo mënyre riprodhimi të sinjaleve, tingujve ose pamjeve dhe/ose tingujve dhe pamjeve njëherësh, me ose pa tel, për marrjen e tyre nga publiku në mënyrë që:

i) transmetimi i sinjaleve, mbartëse të programit/veprës që i ofrohet publikut, të mundësohet nëpërmjet pajisjeve për ç`kodim (deshifrim) të sinjaleve nga një ofrues i shërbimit mediatik audioviziv ose nga një palë e tretë e autorizuar prej saj;

ii) futja e sinjaleve, mbartëse të programit/veprës, që synohet të merren nga publiku, të mundësohet nga zinxhiri i pandërprerë i përcjelljes që, nën përgjegjësinë e shoqërisë transmetuese, përcillet në satelit dhe zbret drejt tokës dhe që më tej njihet si “transmetim nëpërmjet satelitit”;

e) të drejtën e ritransmetimit, e cila nënkupton të drejtën ekskluzive për përcjelljen në publik në mënyrë të patjetërsuar, të pandërprerë, të njëkohshme të një transmetimi të një vepre të së drejtës së autorit:

i) kur bëhet nga një ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA) te një tjetër ofrues shërbimi mediatik audioviziv;

- ii) kur bëhet nga sistemi me kabëll ose mikrovalor për marrjen nga publiku të transmetimit që vjen nga një tjetër ofrues shërbimi mediatik audioviziv (ritransmetim kabllor);
- ë) të drejtën e përcjelljes në publik të transmetimit, e cila nënkupton të drejtën ekskluzive për përcjelljen në publik të një transmetimi të një veprë të së drejtës së autorit me anë të një altoparlanti, ekrani ose me mjete të tjera të ngjashme teknike;
- f) të drejtën e vënies së veprave në dispozicion të publikut, që do të thotë e drejta ekskluzive për të përcjellë në publik një veprë, me ose pa tel, në mënyrë të tillë që të jetë e arritshme për pjesëtarët e publikut në vendin dhe në kohën e zgjedhur prej tyre.
- 26.** “E drejta e përshtatjes audiovizuale” nënkupton të drejtën ekskluzive të autorit të një veprë ekzistuese të së drejtës së autorit për ta transformuar atë në një veprë audiovizuale, sipas parashikimeve të këtij ligji.
- 27.** “E drejta për të bërë vepra të prejardhura” nënkupton të drejtën ekskluzive të autorit apo titullarit të veprës për të autorizuar çdo përshtatje, për të përkthyer, botuar në një përmbledhje, për të bërë aranzhime muzikore, si dhe çdo transformim tjetër që mund t’i bëhet veprës së tij ekzistuese.
- 28.** “E drejta e shpërblimit për riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal” nënkupton të drejtën për shpërblim të arsyeshëm të autorit nga shitja e materialeve teknike, të cilat bëjnë të mundur mbajtjen/fiksimin dhe riprodhimin e veprave nëpërmjet tekstit, zërit apo figurës, të cilat për shkak të natyrës private dhe personale të përdorimit, mund të riprodhohen pa autorizim, nëpërmjet fotokopjes, regjistrim zëri, videos/figurës, tekstit ose nëpërmjet çdo forme tjetër për përdorim personal privat apo tjetër sipas parashikimeve të këtij ligji.
- 29.** “E drejta e rishitjes” nënkupton të drejtën e patjetërsueshme, e cila nuk mund të hiqet as edhe paraprakisht, të autorit ose të mbajtësit të së drejtës, për marrjen e një shpërblimi bazuar mbi çmimin e përftuar të shitjes për çdo akt rishitje të veprës që ushtrohet në vijim të transferimit të parë të pronësisë së një veprë origjinale arti sipas parashikimeve të këtij ligji.
- 30.** “Eksport” nënkuptohet vendosja në tregun e lire ose daljet nga tregu vendas, për qëllime tregtare, të veprave origjinale ose kopjeve të tyre të ligjshme, të fiksuara në çdo formë.
- 31.** “Ekspozim i një veprë artistike” nënkupton shfaqjen në publik, në mënyrë të drejtpërdrejtë, kryesisht të një veprë origjinale.

32. "Fiksim i parë i filmit" nënkupton formën përfundimtare të filmit që mund të shërbejë për përdorim nga publiku.
33. "Film ose videogram" nënkuptohet fiksimi i parë i asaj çka cilësohet si vepër audiovizuale si dhe çdo sekuençë pamjesh në lëvizje, e shoqëruar ose jo me tingull që, në mungesë të origjinalitetit, nuk cilësohet si një vepër audiovizuale.
34. "Folklor (krijimet popullore)" nënkupton tërësinë e veprave folklorike, që përbëhen nga elemente artistike tradicionale, të përjetësuar dhe të krijuara nga një komunitet ose individ i këtij komuniteti, i cili pasqyron vlerat kulturore e artistike dhe trashëgiminë e këtij komuniteti.
35. "Fonogram" nënkuptohet fiksimi i tingullit të një interpretimi dhe/ose ekzekutimi apo tingujve të tjerë ose paraqitja e tingujve në një formë tjetër, përveç asaj të fiksimit të përfshirë në një vepër audiovizuale.
36. "Fotografi" nënkuptohen pamjet e personave ose të paraqitjeve, elementeve apo ngjarjeve të natyrës ose jetës, të marra nëpërmjet proceseve fotografike, duke përfshirë riprodhimet e veprave të artit figurativ dhe pozave të veprave audiovizuale.
37. "Gravurë" nënkupton veprën artistike e krijuar me gdhëndje në metal, gurë, dru, linoleum.
38. "Huadhënie publike" nënkuptohet vënia në dispozicion për përdorim e një vepre për një periudhë të kufizuar kohe dhe jo për përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta pasurore apo tregtare, përmes institucioneve që lejojnë aksesin e publikut dhe që, për këtë qëllim, kryejnë këtë aktivitet si shërbim publik në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
39. "Import" nënkuptohet vendosja në qarkullimin e lirë ose hyrjet në tregun vendas, për qëllime tregtare, të veprave origjinale ose kopjeve të tyre të ligjshme, të fiksuara në çdo formë.
40. "Informacioni i administrimit të të drejtave" nënkupton çdo informacion të dhënë nga autori ose mbartës tjetër i të drejtave, që identifikon veprën ose një objekt të të drejtave të lidhura, autori ose një mbajtës tjetër i së drejtës ose informacioni mbi kushtet e përdorimit të veprës ose objektit të mbrojtur si dhe edhe numrat apo kodet që përfaqësojnë këtë informacion".
41. "Inspektimi" nënkupton kontrollin për zbatimin e këtij ligji për rastet e kundravajtjeve dhe masave administrative nga inspektoriat që mbulon fushën e mbikqyrjes së tregut në përputhje me ligjin për inspektimin.

42. "Interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit" nënkuptohen aktorët, këngëtarët, muzikantët, valltarët, dirigjentët e orkestrave ose të korit dhe personat e tjerë, të cilët paraqesin, aktrojnë, këndojnë, recitojnë, luajnë, interpretojnë, ekzekutojnë, që drejtojnë një orkestër ose që shfaqin në mënyra të tjera vepra letrare dhe artistike, një shfaqje të çdo lloji, përfshirë format e shprehjes së folklorit, varietete, shfaqjet e cirkut ose shfaqjet me kukulla.
43. "Kalimi i të drejtave pasurore" nënkupton vullnetin kontraktor të autorit ose titullarit të të drejtave për të kaluar tek persona të tjerë në formë ekskluzive ose jocksluzive vetëm të drejtat pasurore mbi veprën sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit civil në fuqi.
44. "Karikatura" nënkupton një ilustrim humoristik që ekzagjeron ose shtrembëron karakteristikat dhe propocionet e një personi për të krijuar një ngjashmëri identifikuese të lehtë pamore.
45. "Kodet e standardeve dhe konformitetit të produkteve" nënkuptohen ato kode teknike të cilat hartohen dhe miratohen nga organet kompetente shtetërore ose subjektet e autorizuara prej tyre, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për standardet dhe konformitetin, me qëllim që të garantojnë mbikëqyrjen e të drejtave të parashikuara nga ky ligj, veçanërisht për sa u përket kodeve të tilla, që lejojnë identifikimin e prodhuesve e të importuesve të produkteve, që lidhen me zbatimin e respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura, të fiksuara në disk optik.
46. "Kopje e një vepre" nënkupton riprodhimin e një vepre, të shprehur në formë materiale.
47. "Krimet kompjuterike apo kibernetike në fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to" nënkuptohen ato vepra penale, qëllimi i të cilave është cënimi i të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to.
48. "Licenca e agjencisë të administrimit kolektiv" nënkupton licencën e cila lëshohet nga Ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit për qëllimin publik të përfaqësimit të interesave të mbajtësve të të drejtave tek këto agjenci kolektive, me anë të së cilës agjencia ushton veprimtarinë e saj për mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave nga përdorimi i një, dy ose disa kategorive të të drejtave nga subjektët përdorues sipas kushteve dhe parashikimeve të përcaktuara në këtëligj dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
49. "Masat teknologjike" nënkuptojnë çdo teknologji, pajisje ose pjesë përbërëse, që është projektuar për parandalimin ose kufizimin e veprimeve në rrjedhën normale të funksionimit

të tyre, lidhur me krijimet ose objektet e të drejtave të lidhura, që nuk janë të autorizuar nga mbajtësit e të drejtave sipas parashikimeve të këtij ligji.

50. “Masë doganore” nënkupton kërkesën e mbajtësit të së drejtës së autorit ose e një të drejte të lidhur me të ose të një AAK-je, për raste të dyshimit të shkeljes së të drejtave në import, eksport ose kalim të paligjshëm të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë të cilat do të bëhen në përputhje me legjislacionin doganor për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.
51. “Mbrojtja automatike, pa asnjë formalitet, e së drejtës së autorit” nënkupton faktin se vepra e autorit mbrohet nga konventat ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacioni për të drejtën e autorit që në momentin e materializimit/realizimit të saj pa kërkuar asnjë procedure tjetër formale njohjeje apo rregjistrimi.
52. “Ndërmjetësimi” nënkuptohet procedura e ndërmjetësimit në një mosmarrëveshje e propozuar nga AAK-të dhe shoqatat e përfaqësuesve të përdoruesve në lidhje me përfundimin e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për ritransmetimin kabllor të transmetimeve në bazë të rregullave për ndërmjetësimin dhe këtij ligji.
53. “Nxjerrje” nënkuptohet transferimi i përkohshëm ose i përhershëm i të gjithë përmbajtjes së bazës së të dhënave ose një pjese të saj në një mjedis tjetër me çdo mjet ose në çdo formë.”
54. “Pantomimë” nënkupton veprimin dramatik, që shprehet me gjeste, lëvizje ose mimikë, por pa fjalë.
55. “Parodia” nënkupton përshtatjen dhe transformimin që bën autori në ndonjë nga gjinitë e artit, në formën e imitimit të veçantë me ekzagjerim të qëllimshëm për efekt komik ose për të për qeshur një dukuri të caktuar.
56. “Përdorimi publik” nënkupton përdorimin e një vepre, krijim i autorit, objekt i këtij ligji, që përcillet në publik ose që është në përdorim në një zonë të arritshme për pjesëtarët e publikut, si dhe që siguron aksesin nga publiku në këtë vepër në çdo kohë ose vend të përzgjedhur në mënyrë individuale nga ana e tyre.
57. “Përkthim” nënkupton paraqitjen e veprës së shkruar ose gojore në një gjuhë tjetër nga origjinali.
58. “Përmbledhje” nënkuptohen vepra të tilla, si: enciklopedi, antologji, fjalorë, përmbledhje të tjera të ngjashme ose përpilime të materialeve dhe të dhënave të ndryshme, gazeta, revista,

recensione dhe periodikë të tjerë, pavarësisht nëse janë të mbrojtura ose jo veçmas nga të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, me kusht që ato, për shkak të përzgjedhjes ose përpunimit të përmbajtjes së tyre, të jenë rezultat i krijimtarisë intelektuale.

59. “Prezumimi si autor i veprës” nënkupton rastin kur në mungesë të fakteve dhe provave për të kundërtën, çdo autor ose grup autorësh emri i të cilit/ve shfaqet mbi një vepër, cilado qoftë mënyra e shfaqjes, konsiderohet autor i veprës, duke provuar sipas rastit, orgjinalitetin, punën krijuese si dhe kontributin e dhënë në të.
60. “Prodhues i fonogramit” nënkuptohet personi fizik ose juridik, i cili ndërmerr nismën dhe mban përgjegjësinë për fiksimin e parë të tingujve në një interpretim dhe/ose ekzekutim apo tingujve të tjerë ose paraqitja e tingujve në një formë tjetër.
61. “Program kompjuterik” nënkupton krijimin në çdo formë të një programi kompjuterik, programet e aplikimit dhe sistemet operative të shprehura në çdo lloj gjuhe, duke përfshirë materialet përgatitore të projektimit dhe manualat.
62. “Pseudonim” nënkupton emrin fiktiv, të zgjedhur nga autori për të përfaqësuar autorësinë e veprës, kur nuk dëshiron të zbulojë identitetin.”
63. “Publik” nënkuptohet një numër personash, më shumë se dy, që gjenden jashtë rrethit të personave të lidhur ngushtë me rrethin familjar ose kanë marrëdhënie të tjera personale me autorin.
64. “Përdorim personal” nënkupton realizimin e një kopjeje të vetme, të një riprodhimi, përkthimi, përshtatjeje ose transformimi të veprës së një tjetri, vetëm për përdorim vetjak, për nevoja studimi ose për kënaqësi vetjake.
65. “Publikim” nënkuptohet bërja e mundur për publikun, me pëlqimin e autorit ose të mbajtësit të të drejtave të lidhura, të kopjeve të një vepre ose objektit të të drejtave të lidhura, me kusht që mundësi i këtyre kopjeve të jetë në atë masë që të përmbushë kërkesat e arsyeshme të publikut, në përputhje me natyrën e veprës ose me objektin e të drejtave të lidhura.
66. “Ripërdorim baze të dhënash” nënkuptohet çdo formë e vendosjes në dispozicion të publikut të të gjithë përmbajtjes së bazës së të dhënave ose të një pjese të konsiderueshme të saj, nëpërmjet riprodhimit dhe shpërndarjes së kopjeve, përmes dhënies me qira, të drejtës për vënien në dispozicion të publikut të përmbajtjes së bazës së të dhënave dhe nëpërmjet çdo forme tjetër të përcjelljes në publik të bazës së të dhënave.

67. “Riprodhim i veprave për përdorim privat dhe vetjak” nënkupton rastet kur një person fizik mund të riprodhojë një vepër me të drejta autori, pa autorizimin e autorit të një vepre ose titullarit të së drejtës së autorit për këtë vepër dhe pa shpërblim, në qoftë se bëhet në jo më shumë se një kopje, në formën e fotokopjes ose me anë të çdo mjeti të ngjashëm nga përdorimi i teknikave fotografike ose të çdo mjeti tjetër që ka efekte të ngjashme me të dhe me çdo mjet tjetër për përdorim privat dhe përdorimi tjetër vetjak, për aq sa kopja nuk është e aksesueshme dhe nuk ka për synim publikun, si dhe nuk ka qëllime tregtare direkte ose indirekte.”
68. “Riprodhim reprografik” nënkupton riprodhimin identik të një vepre në të njëjtin format, të zmadhuar ose të zvogëluar, me anë të fotokopjimit ose me ndihmën e teknologjive të tjera të ngjashme sipas parashikimeve të këtij ligji.”
69. “Riprodhimi pjesor i veprës” nënkupton shkurtime, citime fragmentesh ose të pjesëve të një vepre të së drejtës së autorit, pa autorizimin e autorit ose titullarit të së drejtës dhe pa shpërblim, e cila është botuar ose është vënë në dispozicion të publikut në mënyrë të ligjshme, për të riprodhuar, botuar, përcjellë në publik, për qëllime të kërkimit shkencor, mësimdhënies, studimeve kritike, ilustrimit, argumentimit, referimit ose rishikimit, me kusht që një përdorim i tillë të jetë në përputhje me praktikën e drejtë dhe në masën e kërkuar për qëllimin konkret që kërkohet të arrihet.”
70. “Ritransmetim” nënkuptohet fakti i marrjes dhe i transmetimit në të njëjtën kohë, pavarësisht nga mjetet teknike të përdorura, i shërbimeve programore, televizive të plota dhe të pandryshuara, ose i pjesëve të rëndësishme të shërbimeve të tilla, të transmetuara nga OSHMA, që i drejtohen publikut në përgjithësi...”
71. “Rasti i veçantë i shpërndarjes” nënkupton shpërndarjen e të ardhurave të mbledhura nga agjencitë e administrimit kolektiv nga riprodhimi i veprave të autorit, për përdorim privat ose përdorim tjetër personal, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
72. “Skicë” nënkuptohet varianti paraprak i një vizatimi, pikturë, skulpturë, vepre letrare, shkencore ose muzikore.”
73. “Skulpturë” nënkuptohet vepra artistike, që paraqet një figurë, në mënyrë realiste ose abstrakte, në formë tridimensionale.”

74. "Sporteli unik" nënkuptohet agjencia që kryen funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit nga subjektet përdorues, në emër të agjencive të licencuara, për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave objekt përfaqësimi, që krijohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet agjencive të licencuara të administrimit kolektiv ose sipas rastit me anë të vendimarrjes së KKDA-së.
75. "Sui generis" nënkupton regjimin/kategorinë mbrojtjes së të drejtave për krijuesit e bazës të të dhënave.
76. "Shpërblim" nënkupton përfitimin në para që merr çdo autor/mbajtës i së drejtës nga përdorimi ose çdo formë tjetër e kalimit ose e shfrytëzimit të veprës së tij sipas parashikimeve kontraktore.
77. "Shpërndarje" nënkuptohet shitja ose çdo mënyrë tjetër e përcjelljes, për një shërbim të caktuar, me ose pa pagesë, e veprave origjinale ose kopjeve e tyre, si dhe ofrimi i tyre për publikun.
78. "Tarifë provizore/e përkohshme" janë tarifatat e miratuara nga organet vendimarrëse të agjencive të administrimit kolektiv, të cilat shpallen dhe gjejnë zbatim për aq kohë sa tarifatat e reja nuk janë miratuar sipas procedurës së miratimit të tarifave të shpërblimit, ku përdoruesi i paguan agjencisë së administrimit kolektiv vlerën e barabartë me 60 për qind të vlerës së projekt-tarifave të paraqitura.
79. "Të drejtat e lidhura me të drejtat e autorit" nënkuptohen të drejta si: të drejtat e interpretuesve/ekzekutuesve në lidhje me interpretimet/ekzekutimet e tyre; prodhuesve të regjistrimeve fonografike të tyre; prodhuesve të fiksimeve (regjistrimeve) të para të filmave të tyre; organizatave transmetuese për transmetimet e tyre; botuesve në lidhje me botimet e tyre.
80. "Transmetim" nënkupton përhapjen fillestare me transmetues tokësor, me kabëll ose me satelit të çdo lloji natyre me formë të koduar apo të pakoduar të shërbimeve programore televizive, që i drejtohen publikut në përgjithësi dhe që nuk përfshin shërbimet e komunikimit që veprojnë mbi kërkesat individuale.
81. "Transmetim nëpërmjet satelitit" nënkupton futjen e sinjaleve, mbartëse të programit/veprës, që synohet të merren nga publiku, të mundësohet nga zinxhiri i pandërprerë i përcjelljes që, nën përgjegjësinë e shoqërisë transmetuese, përcillet në satelit dhe zbritet drejt tokës.

82. “Vepër anonime” nënkuptohet vepra e botuar pa emrin ose pseudonimin e autorit.
83. “Vepër arkitekturore” nënkuptohet çdo krijim në fushën e artit të ndërtimit, ku përfshihen vizatimet, skicat, modelet ose strukturat e tjera arkitekturore.
84. “Vepër artistike” nënkupton çdo krijim origjinal, intelektual i një personi fizik, i materializuar, pavarësisht nga forma a mënyra e të shprehurit, që ka për qëllim të prekë ndjesitë e njeriut.
85. “Vepër dramatike” nënkupton ndërthurjen e veprimeve skenike me dialogje e monologje, të një ose më shumë personazheve, të krijuara për t’u shfaqur në skenë, duke përcjellë një realitet të caktuar përmes interpretimit të tyre.
86. “Vepër e artit pamor” është çdo vepër e arteve pamore, si: fotot, kolazhet, pikturat, vizatimet, gravurat, stampimet, litografitë dhe skulpturat, vepra të tilla të arteve të aplikuara, si tapiceritë, qeramikat dhe punimet e qelqit e krijimet fotografike, me kusht që të jenë bërë nga vetë autori ose të jenë kopje që konsiderohen si vepra origjinale arti.
87. “Vepër e artit të aplikuar” nënkupton çdo vepër artistike, realizuar mbi sende të përdorimit praktik, e punuar me dorë ose me mjete industriale.”
88. “Vepër fotografike” nënkupton një pamje të realitetit, të fiksuar në një sipërfaqe të ndjeshme ndaj dritës ose ndaj një mjedisi rrezatues.”
89. “Vepër grafike” nënkupton një vepër artistike, e krijuar duke vijëzuar ose duke përdorur raporte monokrone mbi një sipërfaqe të sheshtë, që realizon një vizatim, një pikturë a një gravurë.”
90. “Vepër kinematografike” nënkupton çdo sekuençë, me pamje të fiksuara në një mbajtës ose shirit celuloidi transparent, të ndjeshëm ndaj dritës, e përshtatshme për t’u shfaqur në një ekran, si një pamje e lëvizshme.”
91. “Vepër koreografike” nënkupton kompozimin e lëvizjeve të krijuara për një spektakël kërcimi ose çdo kompozim i përcaktuar lëvizjesh, të krijuara kryesisht për të shoqëruar veprën muzikore.”
92. “Vepër muzikore” nënkupton veprën artistike, të realizuar nga ndërthurja e tingujve, me ose pa tekst, me vargje ose libret, për t’u ekzekutuar nga instrumente muzikore, nga zëra njerëzorë dhe/ose nga të dyja së bashku.”

93. “Vepër teatrale” është krijimi artistik i një teksti, platforme, partiture a libreti të përfunduar dhe të mundshëm për t’u shfaqur drejtpërdrejt në publik.”
94. “Veprat audiovizuale” nënkuptohen filmat kinematografikë, televizivë, filmat e animuar, reklamat ose filmat e tjerë, videot e shkurtra muzikore, dokumentarët, emisione dhe grafika televizive, si dhe veprat e tjera audiovizuale, të shprehura nga sekuenca të pamjeve lëvizëse të ndërlydhura, me ose pa zë, pavarësisht nga natyra e mjetit në të cilën ato janë të fiksuara.”
95. “Veprat e prejardhura” nënkuptohen krijime intelektuale, që realizohen duke u bazuar në një ose disa vepra që kanë ekzistuar më parë, si përkthimet, përshtatjet, aranzhimet muzikore, ilustrimet, dokumentarët, riprodhimet artistike, faqet e internetit me të dhëna statike ose ndërvepruese, si dhe ndryshime të tjera të krijimeve/veprave letrare, shkencore ose artistike origjinale që mund të transformohen, të rimodelohen ose të përshtaten, dhe të cilat mbrohen si krijime/vepra origjinale në mënyrë të pavarur nga të drejtat e autorit të krijimit origjinal në përputhje me parashikimet e këtij ligji.”
96. “Veprat kartografike” nënkupton hartat, planet skicat, modelet tredimensionale, në fushën e gjeografisë apo të topografisë.”
97. “Videogram” nënkupton mjedisin ku është fiksuar një vepër audiovizuale e materializuar, me ose pa kolonë zanore, që lejon përcjelljen a riprodhimin e veprës.”
98. “Vizatim” nënkupton krijimin, që paraqet objekte dhe/ose elemente imagjinare nëpërmjet vijave.
99. “Poster/Afise”, nënkupton një fletë ku shkruhet njoftimi për një shfaqje për një film, apo tjetër, e cila ngjitet në një vend të dukshëm nga publiku.”
100. “Pulla artistike”, nënkupton elementet e sigurisë së vendosur nga institucioni përgjegjës, e cila është treguese se riprodhimi i kopjeve vjen nga një vepër origjinale.”
101. “Shtypi periodik”, nënkupton tërësinë e gazetave, revistave, që botohen rregullisht, në kohë të caktuar ose në periudha të njëjta.”
102. “Tirazhi”, është sasia/tërësia e kopjeve të një libri, gazete, reviste apo tjetër që shtypen/botohen njëherësh.